

VENDIM
Nr. 443, datë 31.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 699, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS VLORË (SHTESA)’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘By-pass Vlorë (shtesa)’”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, togfjalëshi “...prej 260 289 121 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e një) lekësh...” zëvendësohet me “...prej 260 811 171 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) lekësh...”;

b) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Truall, me sipërfaqe 22 820 (njëzet e dy mijë e tetëqind e njëzet) m², me vlerë 234 650 228 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e tetë) lekë;”.

2. Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, togfjalëshi “...në shumën 260 289 121 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë ...” zëvendësohet me “...në shumën 260 811 171 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) lekë...”;

b) Në nënparagrafin e parë, vlera “- 240 155 150 (dyqind e dyzet milionë e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë...” zëvendësohet me “- 240 677 200 (dyqind e dyzet milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë ...”.

3. Në tabelën bashkëlidhur vendimit shtohet pasuria, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 699, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

‘PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR *BY-PASS* VLORË (SHITESA)’’,
I NDRYSHUAR

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			Vlera Totale (LEKË)	SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Adresa bashkia ose fshati	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe totale	Sip. e shpronësimit (m ²)	Lloji i pasurisë	Çmimi (lekë/m ²)			Vlera (lekë)
8	Arton		Salihu	Karinë Vlorë	2074	1016/2	300	265	truall	1970	522,050.0	522,050.0	Konfirmuar nga ASHK-ja
TOTALI												522,050.0	